




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 823, datë 23.11.2016

P Ë R

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.914, DATË 29.12.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN
E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në tekstin e rregullave të prokurimit publik, bashkëlidhur vendimit nr.914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 60, "Urdhri i prokurimit", fjalët "...të vitit ushtrimor..." zëvendësohen me "...të vitit buxhetor..."
2. Në neni 76, "Kohëzgjatja e kontratës", bëhen këto ndryshime:


a) Pika 1 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"1. Autoriteti kontraktor, për fondet buxhetore, prokuron kontratat për një periudhë deri në mbylljen e vitit buxhetor, përveç rasteve kur lidhen kontrata shtesë, në përputhje me shkronjat "b", të pikave 3 e 5, të nenit 33, të LPP-së.

Në çdo rast, financimi i kontratave të prokurimit bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë."

- b) Në nënndarjen e dytë, të pikës 3, fjalët "...brenda vitit ushtrimor..." zëvendësohen me "...brenda vitit buxhetor...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".



KRYEMINISTRI

EDI RAMA